



VENDIMIN
Nr. 79, Datë 26.05.2017

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY MARKET” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”d” të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.05.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licensimin e shoqërisë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatohet se:

Bordi i ERE me Vendimin nr. 50, datë 31.03.2017, filloi procedurën për licensimin e shoqërisë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë Shoqërinë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k, në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 79, Datë 26.05.2017

PËR

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY MARKET” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

An tar t e Bordit

	Pro	Kund r
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____